

AKT THEMELIMI
I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
“ BRUNO ALBANIA” shpk

Ne Tirane, sot me date 01 Dhjetor 2024, ne cilesine e “ortakut themelues”:

Z. Erion Dako, i ditelindjes 24/07/1992, lindur ne Tirane, Shqiperi dhe banues ne Shqiperi, shtetase shqiptare, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes me nr. J20724067U.

Z. Rijad Hasani, i ditelindjes 01/02/1979, lindur ne Podujeve, Kosove, dhe banues ne Prishtine, Kosove shtetas kosovar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes me nr. ID1729865.

ne cilesite e “ortakeve themelues”, me vullnet të lire, të plote e të singerte, hartuan kete akt themelimi per krijimin e shoqerise pergjegjesi te kufizuar me emertimin “ **BRUNO ALBANIA**” shpk mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare“ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “ **BRUNO ALBANIA**” shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”). **Emri tregtar i shoqerise “BRUNO ALBANIA”**.

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.


Shoqëria “BRUNO ALBANIA” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket e shoqerise”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortaket përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen VORE Autostrada TR-DR, KM10, perballe city Park, ZK1167, Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortaket te Shoqerise.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

Qëllimi i kompanisë është : Ne fushen e ndertimit: Projektimi, furnizimi dhe instalimi i impianteve teknologjike dhe mekanike, impianteve te kondicionimit, ngrohjes dhe ventilimit, impianteve hidrosanitare dhe mbrojtjes nga zjarri, impiante kontrolli dhe rregullimi, impiante elektrike te tensionit te mesem dhe te ulet, impiante elektrike speciale, impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, si dhe punime te tjera te percaktuara ne licensen profesionale te leshuar nga institucionet pekatese. Ne fushen e tregtise dhe transportit: Tregtimi dhe transportimi me mjetet e veta ose te te treteve te materialeve, paisjeve, makinerive dhe aksesoreve per impianteve teknologjike dhe mekanike, kondicionimi, ventilimi, ngrohje, pishina, ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe ujitje, procese industriale, impiante rregullimi dhe kontrolli, materialeve dhe paisjeve elektrike dhe elektronike etj. Veprimtari imobiliare: Blerje shitje pasurish te paluajtshme, me qellim rishitje ose dhenie me qira tek te tretet. Import Eksport, tregtim, instalim dhe Sherbim mirembajtje per te gjitha llojet e sistemeve dhe impianteve te ngrohjes, ftohjes, ventilimit, impiantet dhe rrjetet e furnizimit me uje te pijshem, rrjetet e impianteve te mbrojtjes ndaj zjarrit. Import eksport, tregtim, instalim dhe mirembajtje te te gjitha llojeve te sistemeve, pajisjeve dhe impianteve mekanike, elektronike, elektrike, IT-se. Sherbime te specializuara inxhinierike dhe teknike per instalimin dhe mirembajtjen e te gjitha sistemeve mekanike, termike, hidraulike, elektrike, IT etj. Tregtim, instalim, mirembajtje, riparime te te gjitha llojeve te kaldajave per ngrohje, te gjitha llojeve te pompave, paneleve elektronike, elektrike, panelet e komandimit, riparimet dhe avolzhimet e motorrave. Instalimi dhe mirembajtja e te gjitha llojeve dhe teknologjive te Impianteve te Kontrollit dhe monitorimit ne distance te sistemeve ngrohje ftohjes etj. Kryerja e çdo lloj veprimtarie tjetër te lejuar nga ligji. Instalimi dhe mirembajtja e te gjitha llojeve dhe teknologjive te Impianteve te Kontrollit dhe monitorimit ne distance te sistemeve te ngrohje ftohjes etj, kryerja e sherbimit DMD (Diagnostic Monitoring Device) etj, ngritja dhe funksionimi i control room-ëve per mbledhjen, menaxhimin, perpunimin e te dhenave statistikore qe gjenerohen nga sistemet e DMD-se. Sherbime auditimi dhe certifikimi dinamik te eficences se energjise te ndertesave..

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.


KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyhet sapo te hapen llogarite bankare te shoqerise teresisht ne te holla nga "ortaket e shoqerise":



Z. Erion Dako është zoterues i 1 kuote me vlere 50.000 leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z. Rijad Hasani është zoterues i 1 kuote me vlere 50.000 leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asambleja e Ortakeve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres



Asambleja e përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet

1. Sipas këtij akti të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtarinë e funksionimit të shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshime të statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;
 - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
 - dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë është :

Z. Erion Dako, mbajtes i ID me nr. J20724067U.

Administratoret e shoqërisë do të ushtrojnë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar , me të drejtë ripërtëritje.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe një person i treti jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratoret ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem të

veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakeve;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambleja e Ortakeve për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asambleja e Ortakeve edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortaket që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;



b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asambleja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.




Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise " **BRUNO ALBANIA**" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakeve themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKET E SHOQERISE

ERION DAKO



RIJAD HASANI

